

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit) Sesioni 2, Tema: Bujqësia Organike

26 tetor 2022, 10:00 – 12:00
Kantina e Verës 'ISAK', Sarandë

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association, me kontributin e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 2 të Grupit të Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit) me temë " Bujqësia organike" që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021- 2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministrinë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit etj. janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministrinë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: **GP I** – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); **GP II** – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); **GP III** –Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); **GP V** – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20). Në këtë sesion, me kontributin e ekspertëve vendas dhe atij sllovak do të diskutohen shembujt e skemave të mbështetjes financiare në Sllovakia dhe BE-së për bujqësinë organike; baza ligjore dhe modelet e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve dhe institucioneve si dhe situata aktuale në Shqipëri.

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: info@em-al.org

**Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm*

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

**Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e
Konsumatorit)**

Sesioni 2, Tema: Bujqësia Organike

26 tetor 2022, 10:00 – 12:00

Kantina e Verës 'ISAK', Sarandë

10:00– 10:10 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10:10 – 10:20 Hapja e aktivitetit
Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Fjala përshëndetëse

Harallamb Pandehi, N/Kryetari i Qarkut Vlorë

10:20 – 10:45 Bujqësia organike në Shqipëri dhe modelet e oazeve ekologjike

Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar(KASH)

- Zhvillimi i bujqësisë organike në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të bashkëpunimit bujqësor
- Sfidat dhe bashkëpunimi me strukturat shtetërore në nivel vendor dhe qendror

10:45 – 11:00 Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

11:00– 11:45 Bujqësia organike – Eksperienca e Sllovakisë, si vend anëtar i Bashkimit Europian

Ján Baršvára, Drejtor i Departamentit të Bujqësisë dhe Shërbimeve/ Dhoma Sllovaqe e Bujqësisë dhe Ushqimit

- Skemat e mbështetjes financiare për bujqësinë organike- rasti i BE-së dhe Sllovakisë
- Baza ligjore dhe modelet e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve dhe strukturave shtetërore
- Rekomandime për një bashkëpunim efektiv dhe rritje kapacitetesh

11:45 – 12:00 Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

Mbyllja e takimit dhe koktej